


LAPSI



I DEMOKRACISË

DEMOKRACIA NË SHETITIN TONË

RIONA (11), MESUD (10), DAFINA (11), ERIS (10), LEONITA (10), YLLI (11), ASRA (10), UVESA (10)



Në demokraci, barazia është e domosdoshme

Ne jemi shtet demokratik, ku secili prej neve nga mosha 18 vjeçare e ushtron sovranitetin përmes zgjedhjes së përfaqësuesve tanë

Në hapësirën e projektit „Demos-ti“ kaluam shumë mirë sepse jemi ndjerë të lirë dhe aty mësuam shumë për demokracinë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje.

Ne mësuam se demokracia ka shumë gjëra pozitive të cilat ne i quajmë elemente të demokracisë. Këto elemente janë: respekti, solidariteti, toleranca, barazia, paqja, liria, etj. Këto elemente na ndihmojnë që të kemi një jetë të mirë, të qetë dhe pa konflikte.

Ja një shembull se ku mund ta aplikojmë njërin nga elementet e demokracisë: ne si shtet multietnik kemi qytetarë të besimeve të ndryshme fetare dhe padeshim që ne duhet të jemi tolerantë dhe t'i respektojmë edhe qytetarët që kanë besime të tjera, sepse ne jemi të barabartë.

Në Kosovë funksionon demokracia përfaqësuese, ku qytetarët e shtetit tonë dalin në zgjedhje dhe votojnë për personat që kandidojnë për deputet. Këta përfaqësues na përfaqësojnë neve në Kuvendin e Kosovës. Dëshirojmë të theksojmë se demokracia më parë nuk ka funksionuar në mënyrë të drejtë, sepse atëherë ka pasur shumë pa barazi. Ndërsa, tani kemi një demokraci të plotë, ku të gjithë kemi të drejta të barabarta pa asnjë dallim.

Për të lulëzuar një lule nevojitet ujë, njëlloj sikurse ne që kemi nevojë për të drejta. Prandaj, duhet ta duam shtetin tonë dhe demokracinë sepse aty e gjejmë të ardhmen e lumtur.



Gazetarët e „Demos-ti“



Elementet e demokracisë

DEMOKRATËT E VEGJËL

**QEFISERE (11), AGNESA (11), ALBULENA (11), AMRA (10), REINA (11), OMER (10), MERIS (11),
ERVAL (10)**

Demokracia është sistem i qeverisjes ku populli e udhëheq një shtet. Populli e udhëheq shtetin me anë të votave në zgjedhje të lira. Për këtë arsye ne mendojmë se zgjedhjet janë njëra prej elementeve kryesore në demokraci


Zgjedhjet janë një proces shumë i rëndësishëm ku qytetarët mbi moshën 18 vjeçare dalin për të votuar. Qytetarët në këtë proces i votojnë personat të cilët ata mendojnë se do ta zhvillojnë vendin e tyre.

Ne nuk kemi mundësi të marrim pjesë në këtë proces zgjedhor sepse jemi ende fëmijë, por kjo nuk do të thotë që ne nuk mund të zgjedhim apo të votojmë në jetën tonë të përditshme. Çdo ditë, ne kemi mundësi të zgjedhim lojëra të ndryshme, ushqimin e preferuar, veshjen e preferuar etj.

Prandaj, ne mendojmë se është shumë e rëndësishme të votojmë, sepse një votë më shumë e bën ndryshimin për të mirën e vendit.




Gazetarët e demokracisë



Duart tona demokratike



Populli dhe përfaqësuesit e tyre



Votat janë shumë të rëndësishme



Kosova jonë e dashur

TË JEMI QYTETARË AKITIV


UERDA (11), RAJNA (11), ELMEDINA (10), ANISA (10), ALTIN (11), SEAD (10), ARLIND (11), AGON (11)

Ne sot si grupi me emrin „Ylberi“, jemi shumë të lumtur që kemi shkruar këtë artikull. Artikulli ynë ka informata shumë të rëndësishme dhe të dobishme

Të gjithë ne jemi qytetarë të Kosovës. Si të tillë ne kemi shumë të drejta. A e dini pse? Sepse vendi ynë është vend demokratik, që nga 17 shkurti i vitit 2008. Pra, e dijmë se demokracia neve si qytetarë, na jep shumë të drejta. Këto të drejta janë: e drejta e fjalës së lirë, e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e identitetit, e drejta e votës, e drejta e strehimit, e shumë të drejta të tjera. Megjithatë, nuk duhet harruar se ne gjithashtu kemi edhe përgjegjësi ndaj vendit tonë. Përgjegjësi e jona është: të respektojmë njëri-tjetrin, të respektojmë ligjin, të paguajmë taksat, të ruajmë dhe të kujdesemi për pronat publike, etj. Nëse duam sukses atëherë duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të mos i harrojmë përgjegjësitë tona.



Autorët e këtij artikulli



„Demos-ti“, vendi ku u bëmë gazetarë




Ne kemi të drejtë t'i zgjedhim vet përfaqësuesit tanë



Ne e respektojmë ligjin sepse jemi qytetarë shembullor



Jemi të gëzuar si lulet në pranverë, që e kemi demokracinë



Institucioni i Kuvendit është shumë i rëndësishëm në Jetën tonë. Ne e vizatuam atë me shumë dëshirë sepse e konsiderojmë pjesë tonën. Në të ardhmen, ka mundësi që ne të jemi deputetët të cilët punojnë aty

Të dashur lexues të artikullit „Të jemi qytetarë aktiv“, kjo është pjesa e dytë e artikullit tonë, që flet për mënyrat se si ne mund të jemi aktiv dhe të punojmë për të mirën e vendit tonë



Peticioni, njëra nga format se si mund të jemi aktiv

E si mund të jemi aktiv? Aktiv mund të jemi: duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, duke qenë të pranishëm në tubime publike, duke u interesuar dhe duke marrë informacione për vendin tonë, duke nënshkruar peticione, duke u kujdesur për ambientin, etj. Ne si nxënës dhe si fëmijë mund të bëjmë shumë për vendin tonë. Nëse e paramendojmë vendin tonë si trupin e njeriut, ne jemi truri që e bën trupin që të funksionoj. Pa ne, nuk do të aktivizoheshin as muskujt. Andaj, ju ftojme të gjithëve, të jemi truri i cili asnjëherë nuk ndalet së punuari. Ne në të ardhmen do të jemi aktiv dhe do të bëjmë që shteti ynë të jetë i suksesshëm dhe ta njoh e tërë bota. Ju lutemi, të japim gjithmonë më të mirën nga vetja, që të kemi demokraci sepse të gjithë e meritojmë të jemi të lumtur.



Grupi duke punuar në këtë artikull



Të lumtur bashkëpunojmë


MIRATIMI I LIGJIT

ALMIR (10), REZANA (10), JASMINA (11), ADISA (10), MELISA (10), BLEND (11), MAJLINDA (10),
HYLKI (10)

Në këtë artikull merrni informacione lidhur me Kuvendin e Kosovës

Ne sot në grupin tonë duke diskutuar për demokracinë, e cila do të thotë udhëheqje e popullit dhe veprim i lirë, kuptuam se sa i rëndësishëm është një institucion, ku merren vendime për të ardhmen e vendit. Ky institucion është Kuvendi.

Kuvendi është organi më i lartë legjislativ i vendit, sepse aty miratohen ose nuk miratohen ligjet. Këto ligje duhet zbatuar, sepse është mirë për të ardhmen e shtetit tonë. Në Kuvend punojnë deputetët, Kryetari i Kuvendit, etj. Deputetët diskutojnë çështje të ndryshme. Po ashtu, aty bëhen votimet dhe zgjedhet Presidenti i vendit. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera: funksionin kontrollues dhe atë përfaqësues. Në Kuvend punojnë 120 deputetë, ku prej tyre 100 janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 të komuniteteve jo shumicë si: romë, ashkali, serb, turk, egjiptian, boshnjak.



Deputeti, përfaqësues i popullit



Vendi ku punojnë deputetët



Vota jote ndryshon mënyrën e jetesës



Së bashku shkojmë përpara




Gazetarët e ardhshëm

LIGJET NË DEMOKRACI



E drejta e lojës



Kuvendi, organ legjislativ

Demokracia si sistem që na mundëson të drejta të barabarta

Propozimet e ligjeve mund t'i bëjnë deputetët, Qeveria, Presidenti dhe populli, nëse i kanë më shumë se 10.000 nënshkrime. Ligjet që propozohen, bazohen në Kushtetutën që është ligj mbi ligje. Ne e dijmë se në demokraci kemi të drejta të barabarta, p.sh.: e kemi të drejtën e strehimit, të drejtën e arsimit, të drejtën e ushqimit, të dejtën e lojës, të drejtën e familjes, etj. Është mirë t'i kemi të drejtat tona dhe këtë neve na e mundëson demokracia.


Kur një vend është demokratik jemi më të lirë dhe na jepet e drejta që të shprehim mendimet tona lirshëm. Ne kemi një mesazh për ju: të bashkëpunojmë dhe të përkrahim njëri-tjetrin. Gjithmonë duhet ta dijmë se sa e vlefshme është demokracia.



Ne punojmë për një të ardhme më të mirë



E drejta e arsimit



E drejta e punës



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Naim Frashëri“
Klasa: V-5
Vendi: Vushtrri